



**OLIMPIADA E PËRBASHKËT E GJUHËS SHQIPE
PËR KLASËN E NËNTË**

Faza e katërt

23 maj 2026

Emri dhe mbiemri i nxënësit: _____

Shkolla: _____

Qyteti _____

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6
Pikët						
Pyetja	7	8	9	10	11	12a
Pikët						
Pyetja	12b	13	14	15	16	17
Pikët						
Pyetja	18	19	20	21	22	23
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Pjesa I

Lexoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Kujtimet e mia për Prizrenin

Të shtunën e njëzet e katër nëntorit, derisa po ecja mbi Urën e gurit në Prizren, e pashë qytetin ndryshe nga që e kisha parë më herët. Për herë të parë e pashë me sytë e një studenteje. Më herët këtu vija si nxënëse me programe të ndryshme shkollore, kryesisht ekskursione dhe vizita kulturore. Vizita e parë që bënim ishte në Shtëpinë Muze të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Do të më thoni pse së pari aty? Se aty u zhvillua një pjesë e rëndësishme e historisë shqiptare për pavarësinë e Shqipërisë (1912). Ne vizitonim edhe Kalanë e qytetit, ngjiteshim lart mbi rrugicat e ndërtuara shekuj më parë, për të parë bukurinë që rrethon Prizrenin, sheshin e Shadërvanit, Urën e Gurit dhe Lumbardhin e Prizrenit. Po ndalem me kaq kujtime nga vizitat paraprake, për të shkruar pse e pashë ndryshe Prizrenin me sytë e një studenteje. Më parë nuk e kisha vënë re që në një hapësirë kaq të vogël urbane qytetarët shqiptarë, turq, boshnjakë dhe goranë jetonin në një harmoni të rrallë, nuk kisha parë kurrë që në një shesh kaq të vogël të funksionojnë aq paqësisht, xhamia, kisha katolike dhe ajo ortodokse. Këtë harmoni ndëretnike dhe ndërjetare e ndjeva sot në lëkurën time, teksa ndjeva butësinë e borës së bardhë që binte vazhdimisht.

Prizreni më kujton Kyustendilin, qytetin e vogël bullgar ku u rrita

Arritëm në Prizren pak pasi përjetuam borën e parë për këtë vit, të paktën për mua që vij nga Bullgaria. Ndonëse po ngrija nga i ftohti, por me këmbë të thata e pa u larguar shumë, ecja përpara përgjatë vijës sonë, duke ndjekur rrugët e ngushta por të zhblokuara të trotuarëve të Prizrenit, nga stacioni qendror i autobusëve deri në lagjen e vjetër të qytetit. Gjithsesi, për shkak të borës, e kisha shumë të vështirë të ngrija kokën. Kjo lloj ecjeje është sfiduese kur je në terren të panjohur, mirëpo gjatë gjithë kohës u ndjeva plotësisht e sigurt sepse njerëzit në Prizren (si dhe ata në Prishtinë) mbrojnë njëri-tjetrin.

Derisa ecja pashë tregtarët që po pastronin borën përpara dyqaneve të tyre, por prapë kishte pjesë të rrugës ku mund të rrëshqisje, kishte edhe rrugë të kalueshme më lehtë. Nuk ecm vetëm ne, studentët, kishte edhe këmbësorë të tjerë, të gjithë ishin të duruar me njëri-tjetrin, ishin të kujdesshëm që të mos na pengonin ose të mos i pengonim.

Reshjet e borës u rralluan dhe më në fund arrita të ngrija sytë e të dalloja dyqanet, të cilat ishin një fenomen tipik i Kosovës, një përzjerje karakteristike e dyqaneve moderne, bar-kafeve dhe tezgave të së kaluarës. Dritat e ngrohta shkëlqenin nga brenda tyre, e ne mund të shihnim edhe njerëz që bisedonin të qetë, pa nxitim dhe pa stres. Në mendje më vërshuan kujtime: një përzjerje e kujtesës së qytetit të vogël dhe komod ballkanik ku u rrita (Kyustendil) dhe shumëllojshmërisë së ngjyrave të qyteteve të bregdetit të Mesdheut.

Në Prishtinë ndjeva frymën e përbashkët krijuese, pikërisht sikur të gjithë të ishim të përfshirë për të ndërtuar diçka së bashku. Prizreni po ashtu me krijoi atë ndjenjë paqësore të bashkëjetesës në tërësi.

Vizita jonë përfshinte xhaminë historike të Sinan Pashës, kishën ortodokse të Shën Gjergjit dhe katedralen Zonja Ndhimtare. Të gjitha këto ishin të vendosura afër njëra-tjetrës dhe mjaft lehtë për t'i vizituar duke ecur në këmbë. Këta tempuj të tre besimeve të ndryshme, ishin plotësisht funksionale dhe në gjendje perfekte, duke lënë dyert e hapura për besimtarët, turistët dhe hulumtuesit e historisë së artit

Për fat të keq ekskursionit tonë po i vinte fundi. Por si për të na e vërtetuar që vendin e bën kuvendi, bashkudhëtarët tanë nga Universiteti i Prishtinës morën kurajën që të thyenin heshtjen lënguese dhe të na zgjonin nën ritmin e muzikës popullore shqiptare. Muzika, si të ishte një forcë magjike e padukshme, na bashkoi të gjithëve nën një ritëm, duke rrëzuar çdo barrierë e çdo hezitim. Këngë bullgare, greke, polake pasuan shumë shpejt duke shkundur çdo hatërmbetje e çdo hendek kulturor midis nesh.

Për ne ky udhëtim do të mbetet në kujtesë si një nga përvojat më frymëzuese e simbolike që kemi përjetuar ndonjëherë. Simbol i qëndresës tonë ndaj kushteve të vështira të motit ashtu si qëndresa e dikurshme ndaj sulmeve të huaja (kujtojmë Lidhjen e Prizrenit).

Prizrenin do e kujtojmë si simbol i unitetit dhe i bashkimit të të gjithëve nën një flamur të përbashkët, që mbart ngjyrat e të gjithë Ballkanit. Simbol i mirëkuptimit dhe i dëshirës për të rrëzuar ndasitë fetare, politike e kulturore. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, Prizrenin e pamë si një simbol të rebelimit kundër dhunës, përçarjes e lakmisë për pushtet për të na bërë të kuptojmë se duke qëndruar të bashkuar si kombe, si shtete e më e rëndësishmja si njerëz, kemi më shumë të përbashkëta sesa mendojmë.

Prizreni, qyteti me një harmoni të rrallë, Reportazh kulturor për Prizrenin nga studentë nga vende ballkanike.

Marrë nga: <https://exlibris.al/prizreni-qyteti-me-harmoni-te-rralle>

1. Prizreni në këndvështrimin e studenteve na shfaqet si:

1 pikë

- A. hapësirë ku bashkëjetesa kulturore dhe fetare përjetohet natyrshëm në jetën e përditshme.
- B. qendër urbane që tërheq vizitorët kryesisht për shkak të monumenteve historike.
- C. qytet ku trashëgimia historike mbetet më e rëndësishme se jeta bashkëkohore.
- D. qytet që ruan identitetin e vet duke shmangur ndikimet e jashtme kulturore.

2. Harmonia ndëretnike bëhet më e dukshme kur tregohet se banorët:

1 pikë

- A. ndajnë të njëjtën hapësirë urbane dhe bashkëjetojnë në mënyrë paqësore.
- B. lëvizin në të njëjtat rrugë të qytetit pa vëmendje të veçantë ndaj njëri-tjetrit.
- C. zhvillojnë kryesisht aktivitete tregtare në zona të ndryshme të qytetit.
- D. kufizohen kryesisht në rrethin e tyre shoqëror dhe kulturor.

3. Si paraqitet atmosfera e përgjithshme në qytetin e Prizrenit?

1 pikë

- A. E qetë dhe mikpritëse, me ndjenjë të dukshme harmonie mes njerëzve.
- B. E qetë dhe pa tensione të dukshme në marrëdhëniet e përditshme mes njerëzve.
- C. E gjallë dhe e larmishme, ku bashkëjetesa shfaqet në mënyrë të natyrshme urbane.
- D. E gjallë, por me një ndjenjë të përmbytur emocionale në komunikimin mes banorëve.

4. Si ndryshon këndvështrimi i vajzës kur kishte ardhur si nxënëse me kohën kur vjen si studente? ¹

2 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 4)

2 pikë – Si nxënëse ajo ndalet në anën e jashtme, në atë pjesën më të dukshme të qytetit - përmes monumenteve dhe vendeve historike, ndërsa tani, si studente, ajo sheh shpirtin e qytetit, botën e pazhurmë, por që përbën thelbin e jetës në Prizren. Pra, këndvështrimi i vajzës ndryshon nga një vështrim i thjeshtë turistik, në një përjetim më të thellë si studente, ku ajo vëren, gjithashtu, harmoninë ndëretnike, bashkëjetesën ndërfetare dhe frymën njerëzore të qytetit.

1 pikë – Nxënësi përmend vetëm pjesërisht ndryshimin e këndvështrimit, pa e shpjeguar plotësisht ose duke trajtuar vetëm njërën periudhë (si nxënëse ose si studente).

5. Çfarë përfaqëson simbolika më e fuqishme e Prizrenit, sipas vajzave dhe pse ka rëndësi përtej kufijve kombëtarë?

2 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 5)

2 pikë – Nxënësi identifikon qartë se simbolika kryesore e Prizrenit është harmonia, uniteti, bashkëjetesa fetare. Kjo ka vlerë universale, sepse na mëson se popujt janë një dhe ndasitë fetare, politike apo etnike nuk i kanë sjellë asnjë të mirë njerëzimit, por veç shkatërrim. Fiton rëndësi pasi është një lloj bashkëjetese që është e veçantë dhe mund të shërbejë si model për të gjithë.

1 pikë – Nxënësi jep vetëm njërën pjesë të përgjigjes: ose identifikon simbolikën, ose shpjegon rëndësinë e saj, por jo të dyja plotësisht.

¹ Në të gjitha rastet të përgjigjet e hapura: 1. Pranohen formulime të ndryshme që ruajnë kuptimin thelbësor të përgjigjes së kërkuar; 2. Nuk kërkohet riprodhim fjalë për fjalë nga teksti burimor; 3. Gabimet e vogla drejtshkrimore ose gjuhësore të mos ndikojnë në vlerësim kur nuk pengojnë kuptimin e përgjigjes; 4. Kur gabimet gjuhësore, fjalori i papërshtatshëm ose ndërtimi i paqartë i fjalisë cenojnë qartësinë dhe saktësinë e interpretimit, ato të merren parasysh në vlerësim.

6. Në fjalinë: "Këta tempuj të tri besimeve të ndryshme ishin plotësisht funksionale dhe në gjendje perfekte, duke lënë dyert e hapura për besimtarët, turistët dhe hulumtuesit e historisë së artit", fjala "hulumtuesit" përdoret për të treguar njerëz që:
1 pikë

- A. studiojnë historinë, artin dhe trashëgiminë kulturore të objekteve fetare.
B. interesohen për vlerat estetike dhe arkitektonike të ndërtesave historike.
C. vëzhgojnë në mënyrë të përgjithshme jetën kulturore dhe shoqërore të qytetit.
D. vizitojnë objektet kulturore kryesisht për qëllime turistike dhe përvojë personale.

7. Cili është kuptimi i fjalës "lënguese" në fjalinë: "Bashkudhëtarët tanë nga Universiteti i Prishtinës morën kurajën që të thyenin heshtjen lënguese"?
1 pikë

- A. e thellë.
B. e hidhur.
C. e sëmurë.
D. **e mundimshme.**

8. Në fjalinë: "Si për të na e vërtetuar që vendin e bën kuvendi, bashkudhëtarët tanë ia morën këngës", ka: **1 pikë**

- A. një çift sinonimik dhe një shprehje frazeologjike.
B. **një fjalë të urtë dhe një shprehje frazeologjike.**
C. dy shprehje frazeologjike.
D. dy fjalë të urta.

9. Foljen në fjalinë e dhënë rishkruajeni duke e vendosur në kohën e pakryer.
Këtë harmoni ndëretnike dhe ndërftetare e ndjeva sot në lëkurën time.

1 pikë

ÇELËSI (PYETJA 9)

Këtë harmoni ndëretnike dhe ndërftetare e ndjeva sot në lëkurën time.

10. Duke iu referuar paragrafit të parë dhe të fundit, dalloni si ndryshon veta e rrëfimit. Shpjegoni cili është funksioni i përdorimit të vetës në secilin rast?
3 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 10)

3 pikë – Nxënësi identifikon qartë ndryshimin e vetës së rrëfimit dhe shpjegon funksionin e saj në të dy paragrafët. Tregon se në paragrafin e parë përdoret veta e parë njëjës ("unë"), e cila shpreh përjetimin personal, vëzhgimin individual dhe raportin subjektiv të rrëfyeses me Prizrenin. Shpjegon se në paragrafin e fundit përdoret veta e parë shumës ("ne"), e cila zgjeron përjetimin në një ndjenjë kolektive bashkimi, përfshirjeje dhe përvojë të përbashkët mes studentëve.

2 pikë – Nxënësi identifikon saktë ndryshimin e vetës së rrëfimit dhe shpjegon funksionin e njëres prej tyre mirë, ndërsa tjetrën vetëm pjesërisht ose në mënyrë më të përgjithshme.

1 pikë – Nxënësi vetëm identifikon vetat e rrëfimit pa e shpjeguar qartë funksionin e tyre, ose jep një shpjegim shumë të kufizuar e të paqartë.

11. Shpjegoni funksionin e pyetjes retorike në paragrafin e parë të tekstit, duke treguar ndikimin e saj te lexuesi.

1 pikë

1 pikë – Nxënësi identifikon funksionin kryesor të pyetjes retorike dhe shpjegon pjesërisht ndikimin e saj te lexuesi.

12.

- a) Cili është funksioni sintaksor i formës së pashtjelluar në fjalinë: “*Ne ngjiteshim lart mbi rrugicat e ndërtuara shekuj më parë për të parë bukurinë e Prizrenit*”?

1 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 12. A.)

Përgjigje e saktë:

Formë e pashtjelluar: **për të parë** (paskajore)

Funksioni sintaksor: **rrethanor qëllimi**

- b) Rishkruajeni fjalinë në mënyrë që forma e pashtjelluar të kthehet në fjali të përbërë me nënrenditje. **1 pikë**

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 12. B.)

Përgjigje e saktë:

Ne ngjiteshim lart mbi rrugicat e ndërtuara shekuj më parë që të shihnim bukurinë e Prizrenit. (ose: “*me qëllim që të shihnim bukurinë e Prizrenit*”)

13. Nisur nga ideja që përcjell reportazhi, shkruani një paragraf argumentues, ku të shfaqni gjykimin tuaj mbi vlerën e bashkëpunimit dhe solidaritetit mes popujve. **3 pikë**

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 13)

3 pikë – Nxënësi shkruan një paragraf koherent argumentues ku shfaq qartë gjykimin e tij mbi vlerën e bashkëpunimit dhe solidaritetit mes popujve, duke e lidhur me idenë e reportazhit (bashkëjetesa, harmonia, uniteti, kapërcimi i ndasive). Jep të paktën një argument të qartë dhe të zhvilluar dhe mund të mbështetet me shembuj ose ide të përgjithshme shoqërore. Teksti është i kuptueshëm, i organizuar dhe me gjuhë të përshtatshme.

2 pikë – Nxënësi shpreh një qëndrim të përgjithshëm mbi bashkëpunimin dhe solidaritetin mes popujve, por argumentimi është i pjesshëm, i cekët ose pa lidhje të qartë me idenë e reportazhit.

1 pikë – Nxënësi jep vetëm një mendim të thjeshtë ose të paargumentuar (p.sh. pohim i përgjithshëm pa shpjegim), ose teksti është shumë i kufizuar dhe i paqartë.

Pjesa II

14. Kur u dokumentua Formula e Pagëzimit? Përmendni tri arsye që e bëjnë atë një nga dokumentet me rëndësi të veçantë për gjuhën shqipe². **4 pikë**

² a). Pranohet çdo formulim që ruan kuptimin historik të saktë; b) “Arsyet” duhet të jenë të dallueshme (jo e njëjta ide e përsëritur); c). Gabimet e vogla gjuhësore nuk ndikojnë në pikëzim; d). Theksi është te vlera historiko-gjuhësore e dokumentit, jo formulimi i saktë akademik

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 14)

Përgjigje e saktë orientuese

Formula e Pagëzimit u dokumentua në vitin 1462 (shekulli XV) nga Pal Engjëlli. Ajo ka rëndësi të veçantë sepse është një nga dëshmitë më të hershme të gjuhës shqipe të shkruar, dëshmon përdorimin e shqipes në funksion komunikues/fetar dhe tregon ekzistencën e hershme të shkrimit shqip në dokumente historike.

4 PIKË — NIVEL I LARTË

Nxënësi:

- jep saktë kohën e dokumentimit (1462 / shek. XV)
- përmend 3 arsye të sakta dhe të dallueshme, si p.sh.:
 - është ndër dokumentet më të hershme të shqipes së shkruar
 - dëshmon ekzistencën e gjuhës shqipe në formë të shkruar
 - tregon përdorimin e shqipes në funksion fetar ose komunikues
 - ka rëndësi historike për studimin e zhvillimit të gjuhës shqipe

Shembull përgjigjeje (4 pikë)

Formula e Pagëzimit u dokumentua në vitin 1462 nga Pal Engjëlli. Ajo është një nga dëshmitë më të hershme të gjuhës shqipe të shkruar, tregon se shqipja është përdorur në dokumente dhe në komunikim fetar, si dhe dëshmon ekzistencën e hershme të gjuhës shqipe në histori.

3 PIKË — NIVEL I MIRË

Nxënësi:

- jep saktë kohën
- përmend 2 arsye të sakta
- ose 3 arsye, por njëra është e pasaktë / e paqartë

Shembull (3 pikë)

Formula e Pagëzimit është dokument i hershëm i shqipes. Ajo tregon përdorimin e gjuhës shqipe dhe ka rëndësi historike për gjuhën tonë.

2 PIKË — NIVEL BAZË

Nxënësi:

- jep saktë kohën dhe vetëm 1 arsye të saktë
- ose përmend 2 arsye të pasakta ose të paqarta

Shembull (2 pikë)

Është një nga dokumentet më të vjetra të gjuhës shqipe.

1 PIKË — NIVEL I ULËT

Nxënësi:

- jep vetëm kohën ose vetëm një pohim shumë të përgjithshëm
- pa shpjegim të arsyeve

Shembull (1 pikë)

U shkrua në shekullin XV.

Pjesa III

Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Atdheu është dheu i birit e i atit e i shpirtit të shenjtë

Në vargun me krushq atdheu është krushku i parë
Në të tëra meshat shenjte ai është Meshari
Në kulm e në flamur është kumti e kremtja
Në kokën rënduar në mendime ai është mendimi

Është një krahë shqipe këtej, një andej kufirit
Është flaka e Oso Kuka në kullën kallë të barotit
Është ara shtatë vjet djerrë e gruaja djerrë e fara

Në bukë e krypë e zemër atdheu është zemra
Në të parën pushkë për ujk atdheu është krisma
Në trupin tonë për vig³ atdheu është vigu
Në mishin tonë për krymb atdheu është ashti⁴

Atdheu është treni në binarin nëntë,
buleta për nesër dhe trasta.

Azem Shkreli, Kashelashë⁵ për atdheun

15. Cili pohim përmbledh më qartë përfytyrimin poetik të atdheut? **1 pikë**
- A. Atdheu është hapësirë e shenjtëruar përmes gjuhës, kujtesës dhe përkatësisë shpirtërore.
B. Atdheu është realitet i ndërtuar kryesisht mbi ngjarjet historike dhe figurat e së kaluarës.
C. Atdheu është bashkim i përvojës historike, kujtesës kolektive dhe përjetimit simbolik.
D. Atdheu është përjetim kulturor i lidhur ngushtë me traditat dhe zakonet popullore.
16. Në poezinë “Kashelashë për atdheun”, poeti thotë: “atdheu është krushku i parë”. Çfarë simbolizon atdheu në këtë varg? **1 pikë**
- A. Forcën që bashkon njerëzit dhe mban gjallë identitetin kombëtar.**
B. Kujtimet e bukura të dasmave dhe traditave familjare.
C. Detyrimet e njeriut për t’iu bindur zakoneve dhe fisit.
D. Figurën më të nderuar të dasmës shqiptare.
17. Struktura e poezisë mbështetet kryesisht në: **1 pikë**
- A. varg të lirë dhe ritëm të brendshëm.**
B. varg të matur dhe rimë të rregullt.
C. varg të lirë pa rimë të rregullt.
D. varg të çrregullt ritmik.
18. Në cilin çift vargjesh shfaqet më qartë shenjtërimi poetik i atdheut? **1 pikë**
- A. Në kokën rënduar në mendime ai është mendimi” / “Në të parën pushkë për ujk atdheu është krisma.
B. Atdheu është dheu i birit e i atit e i shpirtit të shenjtë / Në kulm e në flamur është kumti e kremtja.
C. Është një krahë shqipe këtej, një andej kufirit / Është ara shtatë vjet djerrë e gruaja djerrë e fara.
D. Atdheu është treni në binarin nëntë” / “Në mishin tonë për krymb atdheu është ashti.

³ barelë/lesë

⁴ kockë/esht-ër, ~ ra

⁵ gjëegjëzë

19. Për nga formimi fjala “kashelashë” është:

1 pikë

- A. e parme.
- B. e përbërë.
- C. e përngjitur.**
- D. e prejardhur.

20. Atdheu përshkruhet në disa rrafshë kuptimore. Dalloni një simbol historik dhe një simbol kulturor dhe shpjegoni kuptimin e tyre⁶.

4 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 20)⁷

4 PIKË — NIVEL I LARTË

Kërkesat

Nxënësi:

- identifikon saktë një simbol historik nga poezia
- identifikon saktë një simbol kulturor nga poezia
- jep interpretim të thellë për të dy simbolet
- lidh qartë simbolet me idenë qendrore të atdheut (si ndërtim historik dhe kulturor)

Shembull përgjigjeje (4 pikë)

Simbol historik është Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila përfaqëson kujtesën historike dhe përpjekjet për vetëdije dhe bashkim kombëtar.

Simbol kulturor është “Meshari”, që përfaqëson gjuhën e shkruar dhe trashëgiminë kulturore si bazë e identitetit shpirtëror të shqiptarëve.

Këto simbole tregojnë se atdheu ndërtohet njëkohësisht nga historia dhe kultura, duke bashkuar të kaluarën dhe identitetin kulturor.

3 PIKË — NIVEL I MIRË

Kërkesat

- identifikon saktë dy simbole
- interpreton mirë vetëm njërin simbol
- ose interpreton të dy simbolet, por në mënyrë të thjeshtuar/sipërfaqësore

Shembull përgjigjeje (3 pikë)

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është simbol historik që lidhet me historinë dhe formimin kombëtar shqiptar. “Meshari” është simbol kulturor që lidhet me gjuhën dhe kulturën shqiptare.

2 PIKË — NIVEL BAZË

Kërkesat

- identifikon vetëm një simbol saktë
- ose identifikon dy simbole pa interpretim
- ose ka interpretim shumë të kufizuar dhe përshkrues

⁶ a). analizë e thelluar, jo përshkrim i thjeshtë; b) kuptim simbolik i argumentuar; c) lidhje e qartë me konceptin e atdheut në poezi; d). përdorim i ideve të tekstit për të ndërtuar interpretim

⁷ a) Nu k jepen pikë vetëm për emërtim pa kuptim; b) Interpretimi duhet të jetë i lidhur me funksionin simbolik në poezi; c). Pranohen edhe përgjigje alternative të sakta (p.sh. “kufiri” si simbol historik, nëse argumentohet mirë); d). Vlerësohet kuptimi, jo riprodhimi mekanik i tekstit

Shembull përgjigjeje (2 pikë)

Simbol kulturor është "Meshari".

Simbol historik është Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

1 PIKË — NIVEL I ULËT

Kërkesat

- përgjigje shumë e përgjithshme
- mungesë dallimi mes simbolit historik dhe kulturor
- ose ide e paqartë, pa lidhje me tekstin

Shembull përgjigjeje (1 pikë)

Atdheu lidhet me historinë dhe kulturën e shqiptarëve.

21. Lexoni vargun: "Është një krahë shqipe këtej, një andej kufirit".

Shpjegoni funksionin simbolik të këtij vargu në kontekstin e idesë kryesore të poezisë.

3 pikë

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 21)⁸

3 PIKË — NIVEL I LARTË

Nxënësi:

- interpreton saktë simbolin e "shqipes" si përfaqësim i identitetit kombëtar shqiptar
- shpjegon kuptimin e "kufirit" si ndarje historike dhe politike të hapësirës shqiptare
- lidh vargun me idenë e ndarjes fizike, por unitetit shpirtëror dhe kombëtar të shqiptarëve

Çfarë duhet të shohë vlerësuesi

- interpretim simbolik i plotë
- lidhje e qartë me kontekstin historik shqiptar
- kuptim i idesë qendrore të poezisë (unitet përtej ndarjes)

2 PIKË — NIVEL I MIRË

Nxënësi:

- shpjegon saktë dy nga elementet kryesore (shqipja / kufiri / ndarja kombëtare)
- por interpretimi është i pjesshëm, i paplotë ose pa lidhje të thelluar me idenë qendrore

Shembull orientues (2 pikë)

"Shqipja simbolizon shqiptarët dhe identitetin e tyre. Kufiri tregon ndarjen e tyre në hapësira të ndryshme, por ata mbeten të lidhur si komb."

1 PIKË — NIVEL I ULËT

Nxënësi:

- jep një interpretim shumë të përgjithshëm
- ose përmend vetëm idenë e ndarjes pa shpjegim simbolik
- ose nuk e lidh me vargun në mënyrë të qartë

Shembull orientues (1 pikë)

"Vargu tregon se shqiptarët jetojnë të ndarë nga kufiri, por e duan atdheun."

22. Identifikoni figurën stilistike në vargun: "Në bukë e krypë e zemër atdheu është zemra". Shpjegoni kuptimin e ri që fiton secili element i kësaj shprehjeje.

4 pikë

⁸ a.) Nuk jepen pikë vetëm për emërtim pa kuptim; b). Interpretimi duhet të jetë i lidhur me funksionin simbolik në poezi; c). Pranohen edhe përgjigje alternative të sakta (p.sh. "kufiri" si simbol historik, nëse argumentohet mirë); d). Vlerësohet kuptimi, jo riprodhimi mekanik i tekstit; dh). Pranohet çdo formulim që ruan kuptimin simbolik të vargut; e). Nuk kërkohet riprodhim i saktë terminologjik i tekstit; ë). Vlerësohet interpretimi, jo vetëm përkrahimi; f). Lidhja me idenë bazë të përtej ndarjes është element kyç për pikët e plota

ÇELËSI I VLERËSIMIT (PYETJA 22)⁹

4 PIKË — NIVEL I LARTË

Nxënësi:

- identifikon të paktën një figurë stilistike të saktë:
 - anaforë / përsëritje strukturore (pranohet)
 - metaforë / simbolikë (pranohet)
- shpjegon saktë kuptimin e të tre elementeve:
 - bukë
 - krypë
 - zemër
- jep interpretim të integruar të vargut si tërësi
- lidh kuptimin me idenë e atdheut si vlerë jetësore dhe shpirtërore

Shembull përgjigjeje (4 pikë)

Figura stilistike është anafora (përsëritja e strukturës “në... e... e...”) dhe metafora.

“Bukë” simbolizon jetën dhe nevojat bazë të njeriut.

“Krypë” simbolizon thjeshtësinë, shijen e jetës dhe marrëdhëniet njerëzore.

“Zemër” simbolizon ndjenjën e dashurisë dhe përkatësinë shpirtërore ndaj atdheut.

Vargu tregon se atdheu është i pranishëm në jetën e përditshme dhe në ndjenjën më të thellë të njeriut.

3 PIKË — NIVEL I MIRË

Nxënësi:

- identifikon saktë figurën (anaforë ose metaforë – mjafton njëra)
- shpjegon saktë **dy nga tre elementet**
- jep interpretim të pjesshëm të kuptimit të vargut

Shembull (3 pikë)

“Bukë” lidhet me jetën.

“Krypë” lidhet me thjeshtësinë.

“Zemër” lidhet me dashurinë për atdheun.

Vargu tregon rëndësinë e atdheut në jetën e njeriut.

2 PIKË — NIVEL BAZË

Nxënësi:

- identifikon vetëm një figurë ose e përmend në mënyrë të pasaktë
- shpjegon vetëm **një element simbolik**
- ose jep interpretim shumë të pjesshëm

Shembull (2 pikë)

“Zemra” simbolizon dashurinë për atdheun.

1 PIKË — NIVEL I ULËT

Nxënësi:

- jep përgjigje shumë të përgjithshme
- ose vetëm përshkruan vargun
- ose nuk identifikon kuptim figurativ

⁹ a) Pranohen si të sakta si “anafora” ashtu edhe “metafora”; b) Nuk penalizohet zgjedhja e njëres apo tjetrës figurë, por cilësia e interpretimit; c) Pikët jepen për kuptimin e elementeve dhe integrimin e idesë; d) Emërtimi i figurës nuk është kriter i vetëm vendimtar; dh) Çdo përgjigje që ruan kuptimin simbolik të vargut është e vlefshme

Shembull (1 pikë)

Vargu flet për atdheun dhe rëndësinë e tij.

Pjesa IV

23. Atdheu jeton brenda njeriut në gjuhë, kujtime dhe ndjenja. Nisur nga kjo ide, përshkruani në formën e një eseje çfarë mund të krijojnë së bashku të rinjtë shqiptarë për të ardhmen e atdheut. **10 pikë**

CELESI I VLEREËSIMIT **PIKË — NIVEL I LARTË**

Nxënësi:

- zhvillon një ese të strukturuar (hyrje–zhvillim–përfundim)
- trajton qartë idenë se të rinjtë shqiptarë mund të kontribuojnë në të ardhmen e atdheut
- jep ide të qarta, të argumentuara dhe krijuese (p.sh. arsim, kulturë, shkencë, bashkëpunim, inovacion, ruajtje e identitetit)
- lidh idenë e atdheut me gjuhën, kujtesën dhe ndjenjën si burim motivimi për veprim
- përdor gjuhë të qartë, të pasur dhe koherente

Shembull orientues (4 pikë)

Të rinjtë shqiptarë mund të ndërtojnë së bashku një të ardhme më të mirë për atdheun përmes dijes, bashkëpunimit dhe ruajtjes së identitetit kulturor. Ata mund të kontribuojnë në zhvillimin e arsimit, teknologjisë dhe artit, duke e bërë gjuhën dhe kulturën shqiptare më të pranishme në botë. Duke ndarë kujtimet dhe vlerat e përbashkëta, ata forcojnë ndjenjën e unitetit dhe krijojnë një shoqëri më të drejtë dhe më të zhvilluar...

3 PIKË — NIVEL I MIRË

Nxënësi:

- ka strukturë eseje, por jo plotësisht të zhvilluar
- trajton idenë kryesore të të rinjve dhe atdheut
- jep disa ide të sakta, por të kufizuara ose jo shumë të zhvilluara
- lidh pjesërisht gjuhën/kujtesën/ndjenjën me idenë e atdheut

Shembull (3 pikë)

Të rinjtë mund të punojnë së bashku për të përmirësuar vendin e tyre përmes arsimit dhe punës. Ata duhet të ruajnë gjuhën dhe kulturën shqiptare dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë. Kjo ndihmon që atdheu të ketë një të ardhme më të mirë...

2 PIKË — NIVEL BAZË

Nxënësi:

- shpreh ide të përgjithshme pa zhvillim të qartë
- mungon struktura e plotë e esesë
- idetë janë të pakta ose të përsëritura
- lidhja me idenë e dhënë është e pjesshme

Shembull (2 pikë)

Të rinjtë shqiptarë duhet të punojnë për atdheun dhe ta duan vendin e tyre. Ata mund të ndihmojnë në zhvillimin e shoqërisë...

1 PIKË — NIVEL I ULËT

Nxënësi:

- jep ide shumë të përgjithshme
- nuk zhvillon ese
- mungon argumentimi
- lidhje e dobët me temën

Shembull (1 pikë)

Të rinjtë duhet ta duan atdheun dhe të punojnë për të...

Shtjellimi i idesë	Struktura dhe organizimi	Stili dhe originaliteti	Larmia dhe saktësia gjuhësore	Totali i pikëve
3 pikë	2 pikë	3 pikë	2 pikë	10 pikë

Shënim: Kjo faqe nuk do të merret në konsideratë nga komisioni i vlerësimit. Ajo shërben për të shkruar planin paraprak të esesë.